


“Lufta” për mëditje: praktikat e institucioneve publike rreth udhëtimeve zyrtare



Politikat e mëditjeve



“Lufta” për mëditje:

praktikat e institucioneve publike rreth
udhëtimeve zyrtare

Dhjetor 2019

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrje	5
Metodologjia	6
Korniza ligjore për tarifat e mëditjeve dhe dallimet me praktikat e Komisionit Evropian	8
Rritja e shpenzimeve për udhëtime zyrtare	11
Shpenzimet dhe praktikat e ministrive për udhëtime zyrtare	12
Përshtypjet e shërbyesve civilë për ndarjen e mëditjeve	14
Përfundime dhe rekomandime	18
ANEKS. Rezultatet e anketës me shërbyesit civilë	21

Përmbledhje ekzekutive

Një numër i madh i shërbyesve civilë dhe të emëruarve politik në sektorin publik në Kosovë realizojnë udhëtime zyrtare gjatë vitit për të cilat marrin mëditje. Roli i mëditjeve si instrument është që t'u mundësohet punonjësve të sektorit publik pjesëmarrja në seminare, punëtori, trajnime dhe takime të rëndësishme shtetërore. Në vitin 2018, shpenzimet e institucioneve të Kosovës për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit ishin rreth 14.7 milionë euro. Në kuadër të rritjes së transparencës mbi menaxhimin e financave publike, rritja e llogaridhënies mbi shpenzimin dhe ndarjen e mëditjeve për udhëtime zyrtare është mjaft e rëndësishme. Në këtë raport krahasohen praktikat për mëditje në ministri të ndryshme dhe vlerësohen përshtypjet e shërbyesve civilë për bazën ligjore dhe praktikat dhe meritat e ndarjes së mëditjeve.

Udhëtimet zyrtare rregullohen me një akt nënligjor të vitit 2004. Edhe pse ka ndryshuar korniza ligjore pas shpalljes së pavarësisë dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, institucionet e Kosovës ende mbajnë në fuqi Udhëzimin administrativ 2004/07 i cili bazohet në rregullore të UNMIK-ut. Lidhur me aplikimin e politikave aktuale të mëditjeve në Kosovë, Instituti GAP ka realizuar një anketë me sekretarë të përgjithshëm të 11 ministrive dhe një anketë tjetër me rreth 596 shërbyes civilë. Të gjeturat tregojnë se ka dallime në procedurat që ministrinë ndjekin qoftë për dëshmitë që shërbyesit civilë duhet t'i ofrojnë pas realizimit të udhëtimeve zyrtare qoftë për mënyrën se si vendoset që trajnimet të mbahen brenda ose jashtë Kosovës. Po ashtu, nuk ekziston ndonjë mekanizëm brenda ministrive për të ndaluar marrjen e mëditjeve nga dy burime. Përkundër që ekziston një përshtypje tek shumë shërbyes civilë se ka keqpërdorime të mëditjeve, auditorët e brendshëm nuk kanë arritur të dokumentojnë raste të tilla në tri vitet e fundit. Por, Auditori i Përgjithshëm ka gjetur një numër të devijimeve në praktikat e menaxhimit të mëditjeve dhe gjithashtu ka paraqitur shqetësim lidhur me cilësinë e kornizës ligjore.

Nga anketa me shërbyesit civilë tregohet se ka pakënaqësi brenda institucioneve lidhur me politikat aktuale të mëditjeve, konkretisht se kërkesat për udhëtime zyrtare nuk miratohen në baza të arsyeshme dhe meritore dhe se shpeshherë ka keqpërdorime me mëditje. Po ashtu, mungon një adresë e besueshme ku shërbyesit civilë do të ndiheshin të sigurt t'i paraqisnin rastet e keqpërdorimeve të mëditjeve. Në disa raste, mëditjet e pranuar nga shërbyesit civilë të anketuar dalin të jenë sa 50% e të hyrave mujore të tyre, që paraqesin të hyra të larta shtesë krahas pagës bazë.

Instituti GAP rekomandon që të zëvendësohet Udhëzimi administrativ 2004/07 për udhëtimet zyrtare me qëllim që të përshtatet me realitetin juridik në vend, si dhe të evitohen problemet e identifikuara nga Auditori i Përgjithshëm rreth tatimit të mëditjeve dhe kufizimit të arsyeve për marrjen e mëditjeve. Po ashtu, duhet të ndërtohet një sistem i besueshëm ku shërbyesit civilë mund t'i paraqesin ankesat lidhur me keqpërdorimet e mundshme me mëditje; të shmangen rastet kur niveli i mëditjeve është më i madh se sa paga vjetore; të publikohen të dhëna më të detajuara për mëditjet dhe të publikohet regjistri i vizitave jashtë vendit dhe arsyetimet për to.

Hyrje

Mëditjet për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit përbëjnë 0.62% të shpenzimeve totale në vitin 2018. Por, ka raste kur në baza individuale, të hyrat vjetore nga mëditjet apo paratë e xhepit (20%) janë gati sa dyfishi i pagës vjetore.¹ Tarifë e mëditjeve, sipas udhëzimit administrativ në fuqi, nënkupton shuma që ndahet për një udhëtim zyrtar që mbulon shpenzimet e fjetjes, ushqimit dhe shpenzimet e vogla. Për rastet kur udhëtimi zyrtar kryhet brenda vendit, ai duhet të zgjasë më shumë se 24 orë dhe të jetë jashtë vendit të punës.² Lloji i mëditjes që përfitohet më shpesh dhe nga një numër më i madh i punonjësve në sektorin publik në Kosovë është ai i parave të xhepit (20%) ku shpenzimet tjera mbulohej nga pala pritëse ose organizatorët. Edhe pse Agjencia Kundër Korrupsion ua dërgon formularin për deklarimin e pasurisë 4,819 zyrtarëve publikë, për deklarimin e të hyrave të luajtshme me vlerë prej së paku tre mijë euro, shumë pak zyrtarë publikë i deklarojnë të hyrat nga mëditjet.

Çdo vit, në raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit identifikohen shumë raste të keqpërdorimeve me mëditje³, aq sa vitin e kaluar Auditori i Përgjithshëm kërkoi nga Kryeministri dhe Ministri i Financave që të ndryshohet korniza ligjore për udhëtimet zyrtare dhe vendimi për tarifën.

Me qëllim të identifikimit dhe krahasimit të praktikave për mëditje në ministri të ndryshme, si dhe me qëllim të marrjes së përshtypjeve të shërbyesve civilë për bazën ligjore, praktikën dhe meritat e ndarjes së mëditjeve, Instituti GAP ka kryer një hulumtim të gjerë me sekretarët e përgjithshëm të ministrive dhe me shërbyesit civilë në nivel të ministrive, komunave, agjencive të pavarura dhe Kuvendit të Kosovës. Rezultatet e këtij hulumtimi janë paraqitur në këtë raport.

¹ Në vitin 2014, një këshilltar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik ka raportuar 9,249 euro të hyra vjetore nga mëditjet, kurse pagë vjetore neto prej 4,800 euro. Burimi: <https://bit.ly/2pzzu7k> dhe <https://bit.ly/2JFE4YK>.

² Qeveria e Kosovës. Udhëzimi administrativ nr.MSHP 2004/07 për udhëtimet zyrtare. Burimi: <https://bit.ly/2WmQKZl>.

³ Të gjeturat e ZKA vënë në pah shkelje sikurse përdorim të mjeteve për udhëtime zyrtare në kundërshtim me bazën ligjore, pagesë të mëditjeve në kundërshtim me vendimin e Ministrisë së Financave, mos kthim i avanceve, dhe më shumë. Shih çështjen A2 nga raporti i ZKA për MPMH në 2018, faqe 16 (<https://bit.ly/31RHw8J>). Po ashtu, shih çështjen 9 nga raporti i ZKA për MAP në 2017, faqe 17 (<https://bit.ly/2PtVRuc>) apo çështjen 14 nga raporti i ZKA për MRKS në 2016, faqe 22 (<https://bit.ly/2Nk8qB7>).

Metodologjia

Për të analizuar politikat aktuale të mëditjeve në Kosovë, Instituti GAP ka përdorur burimet primare dhe sekondare të të dhënave. Konkretisht, janë anketuar sekretarët e ministrive dhe shërbyesit civilë në sektorin publik. Ndërsa, si burim sekondar i të dhënave janë përdorur raportet financiare të Ministrisë së Financave që tregojnë shpenzimet e përgjithshme për udhëtime zyrtare ndër vite. Gjithashtu, janë përdorur dokumente rreth mëditjeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Anketa e parë është realizuar me 11 nga 21 sekretarë të përgjithshëm të ministrive. Pjesëmarrës në këtë anketë kanë qenë: Ministria e Pushtetit të Administrimit Lokal (MAPL), Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Zhvillimit Rural (MZHR) dhe Ministria e Integritetit Evropian (MIE). Kurse, sekretarët e ministrive të tjera nuk e kanë plotësuar anketën.

Po ashtu, Instituti GAP ka realizuar edhe një anketë me 596 shërbyes civilë, ku pyetësori është shpërndarë nga Ministria e Administratës Publike (MAP), mirëpo, qasje në rezultate ka pasur vetëm Instituti GAP. Rreth 45% e të anketuarve punojnë nëpër ministri, 45% nëpër komuna, 9% në agjenci të pavarura dhe 1% në Kuvendin e Kosovës. Sa i përket nivelit të pozitës së të anketuarve, shumica e tyre janë pjesë e kategorisë së nivelit profesional, pra ekspertë të fushave të ndryshme. Paga mesatare neto e të anketuarve është 503 euro.

Figura 1. Në çfarë institucioni punoni?





Figura 2. Niveli i pozitës së shërbyesve civilë sipas institucionit



Nga pjesëmarrësit në anketë, 65% ishin burra ndërsa 35% gra. Shpërndarja e moshës së të anketuarve i ngjason shpërndarjës normale, me pjesëmarrje më të theksuar të moshës 25 deri 40 vjeç.

Figura 3. Të anketuarit sipas gjinisë





Figura 4. Të anketuarit sipas moshës



Korniza ligjore për tarifatat e mëditjeve dhe dallimet me praktikatat e Komisionit Evropian

Mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit edhe më tej bazohen në një akt nënligjor të nxjerrë para 15 viteve. Udhëzimi administrativ nr.MSHP 2004/07 për udhëtimet zyrtare është nxjerrë nga Ministria e Shërbimeve Publike dhe bazohet në Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/19 për Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisë në Kosovë.⁴

Edhe pse Ministria e Shërbimeve Publike nuk ekziston me këtë emër që nga viti 2008, Kosova ka shpallur pavarësinë dhe ka aprovuar Kushtetutën e saj dhe asnjë institucion ekzekutiv nuk vepron në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, prapë nuk është nxjerrë udhëzim i ri administrativ. Në qershor të vitit 2018, Qeveria e Kosovës nxori vendim të ri për tarifatat për udhëtimet jashtë vendit, por edhe ky vendim bazohet në Udhëzimin administrativ të vitit 2004.

Udhëzimi administrativ 2004/07 për udhëtimet zyrtare definon se çka nënkuptohet me udhëtimet zyrtare, procedurat e aprovimit dhe pagesave. Bazuar në këtë udhëzim, në vitin 2004, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (tash Ministria e Financave) ka nxjerrë vendim për tarifatat e udhëtimeve zyrtare. Në pikën dy të vendimit, obligohet Departamenti i Thesarit që çdo tre muaj apo sipas nevojës të rishikojë tarifën e udhëtimeve zyrtare. Por, një rishikim i tillë nuk është bërë asnjëherë deri në qershor të vitit 2018, kur qeveria ka nxjerrë vendim të ri për tarifatat. Gjithashtu, ekziston një vendim i Kryeministrit i vitit 2008 që obligon institucionet që ngjarjet që mbulohen me paratë e buxhetit të Kosovës të organizohen brenda vendit.⁵ Mirëpo, i njëjti nuk po zbatohet.⁶

Vendimi i ri për tarifatat e udhëtimeve zyrtare erdhi pas kërkesës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili në maj të vitit 2018, përmes një letre zyrtare drejtuar Kryeministrit, kërkoi rishikimin e kornizës ligjore për udhëtimet zyrtare. Në letrën e Auditorit të Përgjithshëm thuhej se “Udhëzimi administrativ që është ende në fuqi nuk i përgjigjet kërkesave të kohës dhe si i tillë nuk kontribuon në menaxhimin e rregullt, të shëndoshë dhe të mirëfilltë të parësë publike... Andaj, kjo kornizë [Udhëzimi administrativ dhe Vendimi për tarifatat] nuk është e përshtatshme dhe praktike për rrethanat aktuale, duke konsideruar kuadrin e ri ligjor dhe institucional të Republikës së Kosovës”.⁷

Auditori i Përgjithshëm liston mangësitë kryesore të kornizës ligjore ekzistuese, si:

1. Paqartësi për tatimin në mëditje, në pajtim me legjislacionin fiskal;
2. Sqarimet jo formale të Udhëzimit dhe kalkulimi i shpenzimeve të ushqimit dhe mëditjeve nuk janë në përputhje me nenet përkatëse të Udhëzimit;
3. Tarifatat e udhëtimeve nuk janë në përputhje me koston e jetesës, për shkak se nuk janë rishikuar që nga viti 2004;
4. Udhëzimi nuk ka definuar llojet e udhëtimeve zyrtare dhe si rrjedhojë përdoret edhe për rastet e kompensimeve për shkollim dhe ngritje profesionale.

4 Qeveria e Kosovës. Udhëzimi administrativ nr.MSHP 2004/07 për udhëtimet zyrtare. Burimi: <https://bit.ly/2WmQKZl>.

5 Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi nr. 11/12. Burimi: <https://bit.ly/34ghkX6>.

6 Rasti më i vonshëm është ai ku MASHT ka ndarë 25 mijë euro nga buxheti i saj për organizimin e një trajnimit në Durrës (<https://bit.ly/2NqTMrQ>). I njëjti është anuluar vetëm pas raportimit të mediave (<https://bit.ly/2PxGv3n>).

7 Zyra Kombëtare e Auditimit. Rekomandim për rishikimin e kornizës ligjore për udhëtimet zyrtare. E pranuar përmes e-mail.

Vendimi i qeverisë i qershorit 2018 rishikon tarifat, por nuk e prek fare përmbajtjen e Udhëzimit administrativ.⁸ Rrjedhimisht, problemet e përmendura nga Auditori i Përgjithshëm rreth tatimit në mëditje dhe marrjen e mëditjeve edhe për shkollim të zyrtarëve publikë, nuk janë evituar nga qeveria.

Ministri të ndryshme kanë nxjerr udhëzime administrative për udhëtime zyrtare për nevojat e tyre. Shembull i tillë është Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila ka nxjerrë Udhëzimin administrativ për procedurat e realizimit të udhëtimeve zyrtare⁹, si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila më 2009 ka aprovuar Udhëzimin administrativ 2009/4 për udhëtime zyrtare të anëtarëve të Ekipeve Përgatitore Komunale¹⁰. Ministrinë kanë nxjerr udhëzime të veçanta administrative, për të zbatuar udhëzimin administrativ të MAP (ish-Ministria e Shërbimeve Publike) e që edhe kjo është një anomali ligjore sa i përket kornizës për rregullimin e udhëtimeve zyrtare.

Asnjë akt ligjor, e as Udhëzimi administrativ 2004/07 për udhëtimet zyrtare, nuk e specifikon nëse kanë të drejtë të marrin mëditje individët të cilët nuk kanë kontratë me institucionet publike. E ka raste kur këshilltarë të jashtëm, paga e të cilëve paguhet nga donatorë të huaj, marrin mëditje¹¹.

Shteti i Kosovës ka caktuar vlerën maksimale të tarifave për udhëtime zyrtare jashtë vendit bazuar edhe në praktikën e Bashkimit Evropian (BE), konkretisht kufizimin e vënë nga Komisioni Evropian (KE)¹² për udhëtimet zyrtare. Sipas vendimit të rishikuar për tarifat për udhëtime zyrtare jashtë vendit nga Ministria e Financave (MF) në Kosovë, janë caktuar vlera më të ulëta të shpenzimeve ditore në një vend të huaj në krahasim me vlerën maksimale të caktuar nga KE. Dallimet kryesore të këtij vendimi me atë të mëparshmin qëndrojnë në uljen e tarifave për disa nga vendet e rajonit si në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Gjithashtu, ka disa ndryshime në ngritjen e tarifave për disa vende si Kanada, Zvicra dhe Gjermania.¹³

Sa i përket vendeve në Evropë, dallimi në tarifat e udhëtimeve zyrtare është më shumë i theksuar për disa shtete si Bullgaria, Portugalia, Greqia, Hungaria, Sllovakia, Austria dhe Zvicra, për të cilat KE ka vendosur kufi më të lartë për udhëtime zyrtare se sa Kosova. Dallime mes tarifave të KE-së dhe Kosovës, ku më të larta janë ato të KE-së, vërehen edhe për vendet afër Kosovës sikurse Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Ndërsa, ngjashmëri më e madhe në tarifat e akorduara nga KE dhe Kosova vërehen për shtetet si Luksemburgu, Gjermania, Belgjika, Turqia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Franca, ku KE akordon mëditje më të larta sesa Kosova.

8 Ministria e Financave. Vendimi nr.: 30/2018 për udhëtimet jashtë vendit. Burimi: <https://bit.ly/2PwoZt3>.


9 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Udhëzim administrativ nr. 01/2011 për procedurat e realizimit të udhëtimeve zyrtare. Burimi: <https://bit.ly/2JbXDrn>.

10 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 2009/4 për udhëtime zyrtare të anëtarëve të Ekipeve Përgatitore Komunale. Burimi: <https://bit.ly/2qvUoGs>.

11 Në vitin 2018, një këshilltar i Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik (<https://bit.ly/33PfQwm>) ka marr mëditje më shumë se sa secili zyrtar tjetër i kësaj ministrie, edhe pse nuk ka kontratë me MZHE dhe nuk është raportuar si zyrtar publik në Agjencinë Kundër Korrupsion.

12 Komisioni Evropian. Tarifat aktuale të mëditjeve 2019. Burimi: <https://bit.ly/2MKTIT8>.

13 Ministria e Financave. Tarifat për shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit. Vendimi nr. 30/2018. Burimi: <http://bit.ly/2oPEcQ>.

Figura 5. Tarifat për udhëtime zyrtare nga KE dhe Kosova

Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e KE dhe MF


Rritja e shpenzimeve për udhëtime zyrtare

Shpenzimet e institucioneve të Kosovës për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit në vitin 2018 ishin rreth 14.7 milionë euro, që paraqet shumën më të lartë të shpenzuar për këtë kategori që nga viti 2014. Në vitin 2018, shpenzimet për mëditje ishin për 27% apo 3.1 milionë euro më shumë se sa në vitin 2017. Në periudhën 2014-2017, shpenzimet për udhëtime zyrtare kanë ndryshuar nga 10.9 deri në 11.8 milionë euro.¹⁴

Po ashtu, në vitin 2018 ka ndryshuar struktura e shpenzimeve për udhëtime zyrtare ku për dallim nga vitet e kaluara, rritje më të theksuar kanë pasur mëditjet dhe akomodimi për udhëtim zyrtar jashtë vendit. Më 2018, kategoria e mëditjeve për udhëtimet zyrtare jashtë vendit është rritur për mbi 46% krahasuar me 2017 (nga 3 në 4.4 milionë euro) dhe akomodimi për udhëtim zyrtar jashtë vendit është rritur për 76.4% (nga 1.7 në rreth 3 milionë euro). Burime potenciale të rritjes më të theksuar të këtyre kategorive në 2018 mund të jenë rritja e tarifave të mëditjeve sipas vendimit të ri të MF, rritja në mesatare e numrit të ditëve që një përfitues ka qëndruar jashtë vendit, apo mund të jenë realizuar më shumë vizita në vendet për të cilat mëditja është më e lartë.

Rënie prej rreth 15% në këtë periudhë (nga 4.7 në rreth 4 milionë euro), ka pësuar kategoria e shpenzimit të udhëtimit zyrtar jashtë vendit në rastet kur institucioni publik i mbulon tërësisht shpenzimet e akomodimit, ushqimit dhe shpenzimeve të vogla.¹⁵ Ndërsa, siç tregon Figura 6, në periudhën 2014-2017, në vazhdimësi kategoria për shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit ka qenë më e lartë se kategoritë tjera.

Figura 6. Shpenzimet e institucioneve për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit, 2014-2018



Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e raporteve financiare 2014-2018 të MF

¹⁴ Ministria e Financave. Raportet vjetore financiare 2014-2018. Burimi: <http://bit.ly/2mRfcVR>


¹⁵ Tek shpenzimet tjera për udhëtim zyrtar jashtë vendit hyjnë shpenzimet e biletave, taksive, dhe më shumë, dhe shpenzimet tjera të vogla nën vlerën 100 euro.

Shpenzimet dhe praktikat e ministrive për udhëtime zyrtare

Për të analizuar procedurat që ministritë i aplikojnë lidhur me udhëtimet zyrtare dhe dallimet mes ministrive në këtë pikë, Instituti GAP ka realizuar edhe një anketë me sekretarët e përgjithshëm të ministrive. Nga të dhënat e mbledhura, nga 11 ministri që janë përgjigjur në anketën e dërguar nga Instituti GAP, del se MTI ka shpenzuar më shumë për mëditje krahasuar me dhjetë ministritë tjera. Më 2018, kjo ministri ka shpenzuar rreth 236.8 mijë euro për udhëtime zyrtare, ndërsa pas saj renditen MIE me 163.4 mijë euro, MASHT me 142.3 mijë euro dhe MMPH me 137.4 mijë euro.


Sa i përket numrit të përfituesve të udhëtimeve zyrtare të deklaruar nga ministritë, siç vërehet nga Figura 7, numri më i madh është nga MASHT, ku gjatë periudhës 2016-2018 kanë përfituar 967 persona. Vetëm në vitin 2018, numri i përfituesve nga MASHT ka arritur në 541 persona. Vlen të theksohet se të gjithë këta përfitues kanë marrë mëditje ose para xhepi (20%) për udhëtime zyrtare jashtë vendit. Ndërsa, në MTI në vitin 2018 kanë përfituar mëditje për udhëtime zyrtare 179 persona apo 67 më shumë se në 2017. Për dallim nga ministritë tjera, rënie të theksuar në numrin e përfituesve në 2018 ka pasur Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ku kanë përfituar 115 persona apo 37 më pak se në 2017. Kurse, MMPH përkundër që ndan një shumë të konsiderueshme për udhëtime zyrtare gjatë vitit, nuk i ka raportuar numrat e përfituesve. Ngjashëm, informata rreth numrit të përfituesve nuk ka ofruar as MZHE, MPMS dhe MZHR, përkundër që e kanë plotësuar anketën, nuk kanë ofruar detaje të shumta rreth pjesës mbi shpenzimet për mëditje dhe numrin e përfituesve ndër vite. Pra, në MTI dhe MIE vërehet një koncentrim më i madh i shpërndarjes së mëditjeve në një numër më të vogël të shërbyesve civilë, ndërsa shpërndarje tek një numër më i madh i përfituesve vërehet në MASHT, Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) dhe MPB.

Figura 7. Shpenzimet e ministrive për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit dhe numri i përfituesve, 2016-2018



Sa i përket përfituesve sipas klasifikimit të vendeve të punës, bazuar në katalogun e vendeve të punës për shërbyesit civil, në MIE, MASHT dhe MBPZHR, shumë më e madhe për mëditje në periudhën 2016-2018 është shpenzuar nga niveli profesional. Specifikisht, MIE ka ndarë 159 mijë euro, MASHT mbi 188 mijë euro dhe MBPZHR rreth 126 mijë euro. Shumë të konsiderueshme për udhëtime zyrtare nëpër ministri është ndarë edhe për nivelin politik dhe atë drejtues. Për nivelin politik MIE ka ndarë rreth 132 mijë euro, MAPL rreth 74 mijë euro dhe MBPZHR mbi 29 mijë euro. Kurse për nivelin drejtues, MIE ka ndarë mbi 160 mijë euro, MBPZHR rreth 44 mijë euro dhe MAPL mbi 31 mijë euro. Ndërsa, në MPB vërehet një numër më i madh i përfituesve nga niveli teknik-administrativ për të cilët janë ndarë 91 mijë euro.

Figura 8. Shpenzimet e ministrive për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit sipas nivelit drejtues, 2016-2018



Shumica nga ministrinë që janë përgjigjur, përveç MBPZHR, tregojnë se në legjislacionin aktual nuk ka kufizime për numrin e mëditjeve që një shërbyes civil mund t'i marr gjatë një periudhe kohore. Ndërsa, sipas MBPZHR kufiri i lartë për udhëtime zyrtare është 15 ditë. Dallime në mes të ministrive vërehen edhe në pikën së kush i aprovon kërkesat për udhëtime zyrtare. Në disa nga ato, aprovimi ndodh në dy shkallë, nga udhëheqësi/ja i/e departamentit dhe më pas nga sekretari/ja i/e përgjithshëm. Ndërsa, në disa ministri tjera konfirmimi duhet të bëhet edhe nga shërbimi i personelit, nga zyrtari/ja kryesor/e financiar/e ose nga udhëheqësi/ja i/e burimeve njerëzore.

Bazuar në një vendim të Kryeministrit në 2008 institucionet nuk bënë të organizojnë evente jashtë Kosovës nëse ato mbulohen nga paratë e buxhetit të Kosovës.¹⁶ Shumica nga ministrinë e anketuara nuk janë përgjigjur se si vendosin nëse ndonjë trajnim apo ngjarje tjetër duhet të mbahet brenda ose jashtë Kosovës. Sipas përgjigjeve të MAPL dhe MBPZHR nuk ekzistojnë rregulla në këtë pikë, mirëpo qasja e MAPL është se nuk aprovon organizime jashtë vendit nëse ngjarja mbulohet nga buxheti publik. Ngjashëm vepron dhe MPMS. Ndërsa në MBPZHR varet nga vendimi i nivelit drejtues.

Lidhur me kërkesat dhe dëshmitë që përfituesit e mëditjeve duhet të i ofrojnë pas realizimit të udhëtimeve zyrtare, dallojnë në mes ministrive, pasi që disa ministri kërkojnë edhe dokumente shtesë krahas kartelës së embarkimit (boarding pass), faturave të hotelit dhe dëshmisë për pjesëmarrje. Konkretisht, MZHE dhe MZHR

16 Qeveria e Republikës së Kosovës. Vendimi nr. 11/12. Burimi: <https://bit.ly/34ghkX6>.

kërkojnë edhe agjendën e takimeve apo trajnimit dhe ftesën. MZHR kërkon edhe kopjen e faqes së pasaportës ku tregohet vula hyrëse dhe dalëse, kërkesa për udhëtim zyrtar si dhe raport të detajuar për takimet e zhvilluara. Ngjashëm, MASHT dhe MTI kërkojnë raport nga përfituesit lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar. Ndërsa, MAPL, përveç agjendës së takimeve dhe trajnimit kërkon si dëshmi shtesë edhe certifikatat nëse janë lëshuar nga organizatorët.

Sa i përket asaj nëse ekzistojnë procedura që një shërbyes civil të mos mund të marr mëditje nga dy burime, pra nga ministria dhe donatori, përgjigjet e ministrive ishin të ndryshme. Sipas MBPZHR, MTI dhe MASHT ekzistojnë procedura të tilla, pasi që në kërkesë dhe agjendë theksohet nëse organizatori mbulon ndonjë shpenzim ose jo. Ndërsa, sipas MAPL mekanizëm kontrolli rreth kësaj pike ka vetëm për fondet nga njëri donator, konkretisht për fondet IPA/CBC, ndërsa për pjesën tjetër nuk ka rregull të veçantë që duhet ndjekur. Nga përgjigjet e 11 ministrive, asnjëra nga to nuk ka raportuar për ndonjë rast të identifikuar në tri vitet e fundit ku punonjësit nuk i kanë zbatuar rregullat ose kanë abuzuar me mëditje. Po ashtu, nuk vërehet se ministrinë kanë bërë ndonjë vlerësim deri më tash për të analizuar nëse janë të nevojshme seminarët dhe udhëtimet për përmirësimin e performancës në punë.

Përshtypjet e shërbyesve civilë për ndarjen e mëditjeve

Rreth 19% e shërbyesve civilë të anketuar kanë treguar se kanë realizuar udhëtime zyrtare përgjatë gjashtë muajve të kaluar. Ajo çfarë veçohet është se një pjesë e këtyre përfituesve kanë realizuar një numër të madh të mëditjeve gjatë kësaj periudhe, që në raste shkon deri në 35 ditë. Për këtë grup, ku të gjithë ishin nga niveli profesional, mëditjet e pranuar dalin të jenë sa 36 deri 50% e të hyrave të tyre mujore. Ndërsa, 13 shërbyes civilë kanë realizuar 10 deri 19 mëditje, 40 shërbyes civilë kanë realizuar 5 deri 9 mëditje, dhe 53 të tjerë kanë realizuar më pak se 5 mëditje gjatë gjashtë muajve të kaluar. Nga përfituesit e mëditjeve që e kanë treguar pozitën e tyre, pjesa më e madhe janë nga niveli profesional (53), ndërsa pjesa tjetër nga niveli drejtues (35), niveli administrativ-teknik (7) dhe niveli i lartë drejtues (4).

Tabela 1. Numri i shërbyesve civilë të anketuar që kanë përfituar mëditje në gjashtë muajt e fundit

Ditë	Numri i përfituesve
25 ose më shumë	3
20 deri 24	4
10 deri 19	13
5 deri 9	40
<5	54


Lidhur me zbatimin e politikave të mëditjeve në institucionet ku punojnë, 65% e të anketuarve besojnë se mëditjet nuk miratohen në baza të arsyeshme dhe meritore. Po ashtu, mbi gjysma e shërbyesve civilë të anketuar mendojnë se shpeshherë ka keqpërdorime me mëditje, dhe se në rastet kur mëditjet nuk miratohen nuk ofrohet arsyetim adekuat me shkrim. Përshtypja për keqpërdorim të mëditjeve është më e shprehur tek shërbyesit civilë që punojnë nëpër ministri,

ku edhe numri i përfituesve të mëditjeve është më i madh. Koncretisht, nga të anketuarit që kanë përfituar mëditje në gjashtë muajt e fundit mbi gjysma e tyre kanë qenë punonjës nëpër ministri.

Figura 9. Mëditjet në institucionin ku unë punoj miratohen në baza të arsyeshme dhe meritore




Figura 10. Politikat e mëditjeve në institucionin ku unë punoj shpeshherë keqpërdoren




Lidhur me raportimin e rasteve të keqpërdorimit të mëditjeve, 38% e të anketuarve janë shprehur se do t'i raportonin ato tek udhëheqësi/ja i/e njësisë, 22% janë përgjigjur që nuk do të raportonin, ndërsa pjesa tjetër nuk janë përgjigjur fare në këtë pyetje. Po ashtu, mbi 40% e të anketuarve mendojnë se nuk mund të ankohen në mënyrë anonime tek qeveria për rastet e tilla dhe po aq nuk e dinë nëse ekziston mundësia që ta bëjnë këtë gjë. Vetëm 16% besojnë se mund të ankohen në mënyrë anonime. Lidhur me këtë pjesë, 42 nga 596 respondentë janë përgjigjur se frikësohen të raportojnë keqpërdorimet me mëditje tek udhëheqësit e tyre për shkak se nuk besojnë në paanësinë e tyre dhe për shkak të frikës nga hakmarrja, konkretisht në raport me mos lejimin për udhëtime zyrtare në të ardhmen apo largimin nga puna. Koncretisht, në vitin 2018 ekziston vetëm një ankesë e drejtuar nga një shërbyese civile drejt Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSCCK), ku përfituesja e udhëtimit zyrtar është ankuar për mos pagesë të mëditjeve përkundër aprovimit të kërkesës nga institucioni përgjegjës.¹⁷ Po ashtu, rreth gjysma e të anketuarve nuk e dinë nëse institucioni ku ata punojnë ka ndërmarrë ndonjë hap për të përmirësuar politikat e mëditjeve dhe 36% të tjerë mendojnë se nuk është ndërmarrë ndonjë hap në këtë aspekt.

Figura 11. Nëse do të ishit dëshmitar i keqpërdorimit të mëditjeve në institucionin ku ju punoni, tek kush do ta raportonit një dyshim të tillë?



17 Vendimi i KPMSCCK A.nr.69/2018 i pranuar përmes e-mail.

Figura 12. Nuk mund të ankojem në mënyrë anonime tek qeveria nëse mendoj se politikat e mëditjeve janë duke u keqpërdorur




Të gjeturat e anketës tregojnë se mbi dy të tretat e shërbyesve civilë nuk pajtohen se tarifat aktuale për mëditje janë në lartësinë e duhur. Rreth 56% e të anketuarve mendojnë se shuma e ndarë për mëditje të plotë nuk i mbulon shpenzimet e udhëtimit, ndërsa 58% e tyre theksojnë se shuma e ndarë për shpenzime të xhepit nuk është e mjaftueshme. Këto të gjetura përputhen edhe me të gjeturat tona se Kosova ka kufijtë më të ulët për mëditje se KE për një numër të madh të vendeve.

Ndërsa, lidhur me bindjet e shërbyesve civilë rreth qëllimit të mëditjeve si instrument, të gjeturat e anketës tregojnë se rreth 70% e shërbyesve civilë nuk mendojnë se shuma e mëditjeve duhet të jetë aq e lartë sa për t'i rritur të hyrat e tyre. Edhe pse, fakti që afro një e treta e shërbyesve civilë të anketuar kanë bindjen se mëditjet duhet të shërbejnë për rritjen e të hyrave të tyre, që është një keqpërdorim i mëditjeve, mbetet shqetësues. Përkundër qëndrimit të tyre se në institucionin ku ata punojnë ka keqpërdorime në ndarjen e mëditjeve, shërbyesit civilë të anketuar nuk besojnë se mjetet e përfituara ua mundësojnë kolegëve të tyre të kursejnë para për shpenzime familjare. Po ashtu, të gjeturat tregojnë se 64% dhe 73% e të anketuarve i konsiderojnë zgjatjen e kohës së një aktiviteti apo udhëtimet e panevojshme për të fituar më shumë mëditje, respektivisht, si keqpërdorime. Ngjashëm, rreth 60% dhe 65% e shërbyesve civilë janë përgjigjur se marrja e mëditjeve nga dy burime të ndryshme për të njëjtin aktivitet dhe pjesëmarrja në punëtori të padobishme, respektivisht, paraqet keqpërdorim. Mirëpo, edhe në këtë rast, pjesa tjetër e të anketuarve, 40 dhe 35% respektivisht, që nuk i gjykojnë si jo të drejta veprimet e tilla tregojnë për një potencial që kjo kategori buxhetore të keqpërdoret.

Figura 13. Shuma e ndarë për shpenzime të xhepit (20% e mëditjes) është e mjaftueshme



Figura 14. Mëditjet ndikojnë si punonjësit e shpenzojnë kohën sepse mundohen që të i rrisin të hyrat nga mëditjet duke udhëtuar jashtë vendit




Në pjesën ku shërbyesit civilë janë pyetur rreth njohurive të tyre rreth bazës ligjore mbi mëditjet, 39% e tyre mendojnë se stafi nuk mund të marrë paradhënie para udhëtimit, 29% mendojnë se mund të marrë dhe 32% nuk kanë njohuri nëse kjo mund të ndodhë ose jo. Po ashtu, vetëm gjysma e shërbyesve civilë të anketuar pohojnë se ekziston një procedurë zyrtare për rikthimin e parashpëzuar të mëditjeve. Ndërsa pjesa tjetër, që mund të kenë qenë përfitues të mëditjeve dhe pranues të parashpëzimeve në të kaluarën, nuk e dinë (44%) ose mendojnë se nuk ekziston një procedurë e tillë. Mbi 58% e të anketuarve nuk e dinë nëse ka kufizime në bazën ligjore lidhur me numrin maksimal të ditëve për udhëtim gjatë një muaji ose viti. Në pyetjen nëse faturat e hotelit bëjnë pjesë në procedurat e vërtetimit të udhëtimit jashtë vendit, ku ka qenë e mundur të zgjedhet më shumë se një opsion, 59% janë përgjigjur me po. Ngjashëm, 56% dhe 36% janë përgjigjur se edhe vulat në pasaporta dhe kartelat e embarkimit duhen të prezantohen si dëshmi, respektivisht.

Figura 15. Stafi nuk mund të marrë paradhënie (avanc) para udhëtimit



Figura 16. Ekziston procedurë zyrtare për rikthimin e avancit të parashpëzuar të mëditjeve



Përfundime dhe rekomandime

Më 2018, shpenzimet e institucioneve të Kosovës për udhëtime zyrtare brenda dhe jashtë vendit ishin rreth 14.7 milionë euro, që paraqet shumë më të lartë të shpenzuar për këtë kategori nga viti 2014. Nga anketa e zhvilluar me 11 nga 21 ministri, del se në MIE, MBPZHR dhe MASHT, shumë më e madhe për mëditje në periudhën 2016-2018 është shpenzuar nga niveli profesional. Në MTI dhe MIE vërehet një koncentrim më i madh i shpërndarjes së mëditjeve në një numër më të vogël të shërbyesve civilë, ndërsa shpërndarje tek një numër më i madh i përfituesve vërehet në MASHT, Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) dhe MPB. Ndërsa, nga anketa me shërbyes civilë del se 65% e të anketuarve besojnë se mëditjet nuk miratohen në baza të arsyeshme dhe meritore. Dhe, mbi gjysma e shërbyesve civilë të anketuar mendojnë se shpeshherë ka keqpërdorime me mëditje, dhe se në rastet kur mëditjet nuk miratohen nuk ofrohet arsyetim adekuat me shkrim.

Me gjithë nivelin e lartë të shpenzimeve për mëditje, baza ligjore për kategori e shpenzimeve është tejet e vjetërsuar. Në anën tjetër, institucionet zbatojnë këtë bazë ligjore sipas interpretimeve të tyre, ndërsa disa institucione kanë nxjerrë bazë të tyre ligjore për rregullimin e mëditjeve. ZKA nuk ka bërë ndonjë auditim të performancës nëse proceset në aprovimin e udhëtimeve zyrtare kontribuojnë në arritjen e rezultateve për institucione. Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, keqpërdorimet mund të vijnë më shumë nga procese që nuk janë të rregulluara fare me legjislacionin aktual. Gjithashtu, duke marrë parasysh qëndrimet neutrale të një numri të konsiderueshëm të shërbyesve civilë për keqpërdorime të tilla si: marrja e mëditjeve nga dy burime të ndryshme, marrja pjesë në punëtori të panevojshme apo zgjatja e aktiviteteve me qëllim që të përfitohet nga mëditjet, tregon për një potencial që kjo kategori buxhetore të keqpërdoret. Identifikimi i keqpërdorimeve të mëditjeve bëhet edhe më i vështirë kur kemi parasysh perceptimin tek një numër i madh i shërbyesve civilë se nuk do të mund të raportonin keqpërdorime të tilla në mënyrë anonime.

Për të rregulluar shpenzimet e institucioneve për udhëtime brenda dhe jashtë vendit është e rëndësishme që:

- Të përditësohet udhëzimi administrativ aktual për udhëtime zyrtare me këto pika:
 - » Të përcaktohet një formë e standardizuar që duhet ndjekur për aprovimin e mëditjeve në sektorin publik dhe procedurat që duhen të përmbushen për rastet që refuzohen. Konkretisht të ofrohet përgjigje me shkrim lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesës për udhëtim zyrtar;
 - » Me qëllim të shmangies së demotivimit të shërbyesve civilë si pasojë e perceptimeve për padrejtësi në qasjen për udhëtime zyrtare dhe mëditje, të precizohet në bazë ligjore se si sigurohet transparenca brenda institucionit në mënyrë që shërbyesit civil të çfarëdo niveli të kenë qasje në dokumentet dhe arsyetimin e institucionit lidhur me aprovimet apo refuzimet e udhëtimeve zyrtare;
 - » Të përcaktojë edhe rastet nëse dhe kur një person që nuk ka kontratë me institucionet publike mund të marrë mëditje për udhëtime zyrtare;

- » Të përcaktohen së në cilat raste nuk paguhen mëditje për udhëtime zyrtare. Shembull, nëse duhet të paguhen mëditje për rastet e shkollimit për një kohë të gjatë jashtë vendit apo çështje tjera të ngritjes profesionale;
 - » Të përcaktohet se në cilat raste paguhet tatimi në mëditje. Shembull, Bullgaria e obligon tatimin në mëditje vetëm në rastet kur mëditja i tejkalon shpenzimet;
 - » Të qartësohet nëse institucionet përkatëse kanë të drejtë të nxjerrin legjislacion apo rregullore për mëditje;
 - » Të precizojë dokumentet e nevojshme për dëshmitë e pagesës së mëditjeve;
 - » Të përcaktohen kriteret brenda udhëzimit administrativ për udhëtime zyrtare se kur lejohet të ndodhin organizime jashtë Kosovës, sikurse trajnime ose diskutime për dokumente;
 - » Të shtjellohet brenda udhëzimit administrativ që shërbyesit civilë kanë të drejtë të propozojnë pjesëmarrjen në trajnime ose konferenca të cilat lidhet më fushëveprimin e tyre;
 - » Me qëllim të lidhjes së udhëtimeve jashtë vendit me performancën e institucionit, udhëzimi duhet të përmbajë një formë (template) që tregon se si aktivitetet për udhëtime jashtë vendit kontribuojnë në arritjen e objektivave të institucionit;
 - » Të obligohen ministritë që të bëjnë vlerësime ku tregohen nevojat e stafit për trajnime ose seminare specifike, që do të ndikonin në rritjen e performancës së tyre në punën që bëjnë;
 - » Institucionet publike të publikojnë të dhëna të detajuara për udhëtimet zyrtare jashtë vendit, duke përfshirë qëllimin, kohëzgjatjen, numrin e personave që kanë marr pjesë në udhëtime zyrtare, emrat e pjesëmarrësve dhe shpenzimet buxhetore që ndërlidhen me udhëtimet;
 - » Të precizohen përqindja e uljes së pagesës për akomodim dhe mëditjet në rastet e qëndrimeve më të gjata jashtë vendit.
- Duhet të ndërtohet një sistem i besueshëm ku shërbyesit civilë mund t'i raportojnë keqpërdorimet e mundshme me mëditje. Me qëllim të mbrojtjes së sinjalizuesve dhe nxitjes së raportimeve për keqpërdorime, institucionet duhet të krijojnë mekanizma që Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve në fuqi të zbatohet në praktikë edhe sa i përket mbrojtjes së parasë publike nga keqpërdoruesit potencial me mëditje.
 - Duke marrë parasysh nivelin e ultë të informimit të raportuar nga shërbyesit civil lidhur me mundësitë për raportim të keqpërdorimeve, Qeveria e Kosovës duhet të organizojë një fushatë informuese për shërbyesit civil lidhur me mundësitë që ofron Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve.
 - ZKA duhet të bëjë auditime të performancës për mostra të caktuara të udhëtimeve zyrtare me qëllim të matjes së arsyzhmërisë dhe rezultateve në realizimin e objektivave të institucioneve përkatës.

- Ministria e Financave duhet t'i rishikojë tarifat për mëditje sipas afateve të përcaktuara në bazën ligjore për mëditje.
- Duhet të përcaktohet një target i preferueshëm (jo obligativ) lidhur me numrin e udhëtimeve zyrtare që një shërbyes civil mund t'i realizojë brenda vitit, në mënyrë që i njëjti të shërbejë si indikator për rritjen e mundësive edhe për shërbyesit tjerë civilë dhe mos të ndodhë që mëditjet të jenë të koncentruara vetëm tek disa persona. Përfshirje në përdorimin e këtij indikator të bëjnë pozitat që ngërthejnë aktivitete sikurse takime të shumta me institucionet të huaja dhe donatorë të ndryshëm, trajnimet e ndryshme, si dhe projektet e reja të cilat mund të implementohen nga një grup i vogël i shërbyesve civilë.
- Agjencia Kundër Korrupsion të tregohet më strikte në rastet kur zyrtarët publikë nuk deklarojnë mëditjet që kapin vlerën mbi 3,000 euro dhe rastet kur nuk raportohen këto të hyra të dërgohen si shkelje ligjore në gjykatë.

ANEKS. Rezultatet e anketës me shërbyesit civilë

Për secilën nga këto deklaratata, ju lutem na tregoni nëse nuk pajtoheni aspak, nuk pajtoheni, pajtoheni ose pajtoheni plotësisht.

Figura 17. Jam i/e kënaqur me politikat e mëdijve në institucionin ku unë punoj




Figura 18. Mendoj se shuma për mëditje duhet të i mundësojë punonjësve të kursejnë para për shpenzime familjare ose blerje të ndryshme




Figura 19. Shuma e ndarë për mëditje në institucionin ku unë punoj u mundëson punonjësve të kursejnë para për shpenzime familjare ose blerje tjera të ndryshme




Figura 20. Udhëtimet në institucionin ku unë punoj nëse nuk miratohen marrin arsyetim adekuat me shkrim




Figura 21. Në gjashtë muajt e fundit, a keni marrë mëditje ose para xhepi për ndonjë udhëtim?



Figura 22. Në të shumtën e rasteve mëditja ka qenë:




Figura 23. Në gjashtë muajt e fundit, sa ditë përafërsisht në total keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet për të cilin keni marrë mëditje, brenda apo jashtë vendit?




Figura 24. Sa është shuma e përafërt në total që e keni marrë për mëditje për këto aktivitete në gjashtë muajt e fundit (në Euro)?





Figura 25. Në gjashtë muajt e fundit për aktivitetet që keni pranuar mëditje, sa ditë kanë qenë udhëtime jashtë vendit?



Për secilën nga këto deklaratata që kanë të bëjnë me politikat dhe procedurat aktuale në lidhje me mëditjet, ju lutem na thoni nëse i konsideroni si të vërteta apo të pavërteta:

Figura 26. Nuk kërkohet arsyetim me shkrim për të shpjeguar se ndonjë seminar apo udhëtim zyrtar është i nevojshëm për rritjen e performancës në punën time




Figura 27. Ka kufizime lidhur më numrin e ditëve që një punonjës mund të udhëtojë brenda një periudhe kohore (ditët maksimale të udhëtimit gjatë një muaji ose viti)




Figura 28. Cilat janë procedurat e vërtetimit të udhëtimit jashtë vendit me qëllim të arsytimit të mëditjeve në institucionin që ju punoni? (zgjedhje të gjitha që aplikohen)





Figura 29. Si do të i vlerësonit njohuritë tuaja sa i përket politikave dhe proceduarve të mëditjeve në institucionin ku ju punoni?



Ju lutem më thoni për secilën nga këto nëse mendoni se konsiderohet “keqpërdorim në mëditje” ose jo.

Figura 30. Zgjatja e kohës së një aktiviteti për të fituar më shumë mëditje




Figura 31. Angazhimi në aktivitete apo detyra, si udhëtime të panevojshme, për të marrë më shumë mëditje




Figura 32. Marrja e mëditjeve nga dy burime të ndryshme për të njëjtin aktivitet




Figura 33. Marrja pjesë në punëtoritë të cilat nuk janë të dobishme për punën




Figura 34. Në institucionin ku ju punoni a është ndërmarrë ndonjë hap për t'i përmirësuar politikat ose për të parandaluar keqpërdorimin e mëditjeve?




Figura 35. Sa do të thoni se arrinë paga juaj mujore bazë pas taksave (neto), duke përjashtuar përfitimet shtesë si akomodimi, trajnimet, transporti?

€503
(mesatarja)

Figura 36. Sa është vlera e përafërt e mëditjeve që merrni brenda një viti të zakonshëm?

€207
(mesatarja)

Për secilën nga këto deklarata, ju lutem na tregoni nëse nuk pajtoheni aspak, nuk pajtoheni, pajtoheni ose pajtoheni plotësisht.

Figura 37. Politikat e mëditjeve në institucionin ku unë punoj shpeshherë keqpërdoren, sipas institucionit




Figura 38. Mëditjet në institucionin ku unë punoj miratohen në baza të arsyeshme dhe meritore, sipas institucionit






Figura 39. Në gjashtë muajt e fundit, a keni marrë mëditje ose para xhepi për ndonjë udhëtim? (sipas institucionit)





Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt mbështetet nga:

*Support to
Anti-Corruption Efforts
in Kosovo Project
— SAEK*



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Generously
funded by -



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

“Lufta” për mëditje:
praktikat e institucioneve publike
rreth udhëtimeve zyrtare